



## REPubLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0569

Paditësi

Korporata Energjetike e Kosovës, SH.A, Prishtinë.

*kundër**E paditura/Ankuesja*

**N.SH. "IMB Mulliri"** (në likuidim), e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0124 të datës 22 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0124 të datës 22 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

**Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 08 prill 2015, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN113-0370 të datës 09.03.2015, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 30 tetor 2013, për kompensimin e faturave të pa

paguara të energjisë elektrike në shumë prej 7.942,49 euro, për shifrat DFE-9005536 dhe DFE-9012362, refuzohet si e pa bazuar me arsyetimin se kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenit 374 të LMD-së të vitit 1978. Për më tepër në këtë vendim thuhet se bazuar në kontratën e shitjes të lidhur mes AKP-së për NSH "IMB Mulliri" (në likuidim) dhe "B" SH.P.K. të datës 28 prill 2008, seksioni A, pjesa e 6-shtë- detyrimet theksohet se obligimi për energjinë elektrike që kanë lindur në periudhën 3 mujore pas hyrjes në fuqi të kësaj deklaratë përkatësisht pas datës së privatizimit në 28 janar 2008, i takon blerësit të ri. Një konstatim të ngjashëm AKP-ja e jep edhe lidhur me kontratën e nënshkruar ndërmjet AKP-së për NSH "IMB Mulliri" (në likuidim) dhe B J si blerës të datës 10 maj 2011. Padiësi në ankesën e tij e kundërshton qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është e parashkruar. Padiësi pohon se neni 374 i LMD nuk duhet të aplikohet si i izoluar por në lidhmëri me dispozitat e neneve të tjera të këtij ligji përkatësisht neni 360.3 të LMD-së të vitit 1978, sipas të cilit nuk mund të përfillet zyrtarisht parashkrimi nga organi që e vendos çështjen nëse atë nuk e ka invokuar vetë debitori. Tutje padiësi pohon se borxhi për energjinë e shpenzuar elektrike është krijuar, dhe është i pa mohueshëm, andaj duhet të aprovohet ankesa e tij. Bashkë me këtë ankesë padiësi ka bashkangjitur transaksionet e konsumatorit me shifrën DFE-9012362, transaksionin e konsumatorit me shifrën DFE-9005536, prerjen e borxhit për konsumatorin e privatizuar me numër DFE-9012362, prerjen e borxhit e konsumatorit me nr. DFE-9005536, dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRN113-0370 të datës 09 mars 2015 si dhe një parashtrësë të dt. 14 prill 2014 për përgjigje në krekës e AL lidhur me dy shifrat DFE-9005536 dhe DFE-9012362 .

Me 30 mars 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja konsideron se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se padiësi ka dështuar të ofroj prova për të mbështetur kërkesën e tij, në pajtim me nenin 7 të LPK-së. AKP-ja pohon se padiësi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit duke konsideruar se vetëm ligjshmëria e këtij vendimi në bazë të nenit 74.2 të LDHP mund të kontestohet në DHPGJS. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë konsideron se kërkesa e padiësit

është parashkruar pasi që ai ka dështuar të ofroj prova se këtë borxh të pretenduar ndaj NSH-së e ka kërkuar brenda 3 viteve, siç kërkon neni 374 i LMD-së. AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit ishte për pagesën e faturave të pa paguara për periudhën prej 13.10.2002 e deri me 21.10.2013, ndërsa kërkesën e ka parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit me 30 tetor 2013. AKP-ja po ashtu pohon se në bazë të kontratave të shitjes të vitit 2008, përkatësisht 2011, borxhi i krijuar pas privatizimit të NSH-së është borxh për blerësin e ri, ndërsa borxhi i pretenduar për periudhën e para privatizimit të NSH-së siç u tha është i parashkruar. Në mbrojtjen në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me 06 maj 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-15-0664 e aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit, ndërsa e anulon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit në lidhje me borxhin e kërkuar në emër të shifrës DEF-9005536 si dhe detyron AKP-në të paguaj shumën e kompensimit prej 1.277,53 euro në emër të energjisë së shpenzuar elektrike nga NSH "IMB Mulliri" (në likuidim). Shkalla e I-rë me pikën e II-të të dispozitivit të Aktgjykimit e refuzon pjesën tjetër të kërkesës lidhur me borxhin e specifikuar që evidentohet me shifrën DFE-9012362 në shumë prej 6.664,96 euro, në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike nga NSH "IMB Mulliri" (në likuidim). Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në lidhje me borxhin që e pretendon paditësi ndaj të paditurës e që i referohet shifrës DEF-9005536, Gjykata ka gjetur se palët në procedurë kanë bërë prerje të borxhit për konsumatorin e privatizuar dhe se borxhi i cili i përket shifrës DFE-9005536 i përket periudhës kohore të vitit 2011, ndërsa kërkesa për këtë borxh është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 30 tetor 2013, që do të thotë kjo kërkesë e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Andaj në kuptim të nenit 17 të LMD-së e paditura ka për detyrim kompensimin e borxhit në shumë prej 1.277,53 euro për energjinë e shpenzuar elektrike. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se kërkesa e borxhit që kërkohet me shifrën DFE-9012362 në shumën prej 6.664,96 euro në bazë të nenit 374.1 të LMD-së të vitit 1978 është parashkruar, pasi që paditësi nuk e ka kërkuar borxhin brenda 3 viteve.

Me 24 qershor 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-15-0664 të datës 06 maj 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja pohon se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. AKP-ja konsideron se Gjykata e Shkallës së I-rë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike duke pohuar se kërkesa për borxhin e pretenduar ishte e periudhës prej 13 tetor 2002 e deri me 21 tetor 2013, dhe se nuk ka asnjë provë të paraqitur para Autoritetit të Likuidimit, që paditësi të ketë kërkuar këtë borxh para ndonjë autoriteti kompetent. Tutje AKP-ja pohon se bazuar në kontratat e shitjeve të datës 28 prill 2008 dhe 10 shkurt 2011, seksioni A, pjesa e 6-shtë – detyrimet theksohet se çdo detyrim i lindur pas datës së privatizimit të NSH-së i takon blerësve të ri, "B" SH.P.K. dhe B J. Tutje AKP-ja konsideron se kërkesa me të drejtë është refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit, pasi që ajo në bazë të nenit 374 të LMD-së ishte parashkruar. Në ankesë AKP-ja pohon se paditësi nuk ka saktësuar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe se në këtë procedurë duhet verifikuar vetëm ligjshmërinë e vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 30 korrik 2021, paditësi e dorëzoi një parashtesë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtesë paditësi i tregon zhvillimet procedurale që kanë ndodhur lidhur me kërkesën e tij të paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit, duke pohuar se Autoriteti i Likuidimit nuk ka rol dhe as funksionin e Gjykatës por është organ vendimmarrës për shqyrtimit e kërkesave në likuidim. Tutje paditësi pohon se për borxhin e pretenduar ka bashkangjitur prova të mjaftuara dhe ka kërkuar që të aprovohet kërkesa e tij si e bazuar.

Me 05 maj 2022, Kolegji i Apelit i DHPGJS me Aktvendimin AC-I-21-0447 e aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, anuloi Aktgjykimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0664 të datës 06 maj 2021 dhe lëndën e kthehej në rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS, tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit kishte vërejtur se në lëndën mungonin dy kontratat e privatizimit, ndërsa

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk i kishte kërkuar këto dy kontrata dhe as AKP-ja ato kontrata nuk i ka dorëzuar. Po ashtu Kolegji i Apelit kishte vlerësuar se në lëndën në fjalë është rëndësishme të shqyrtohen kushtet e këtyre kontratave dhe obligimet që kanë marrë palët në bazë të këtyre kontratave, e natyrisht edhe të vërtetohet saktë data e lidhjes së këtyre kontrata dhe të vërtetohet data e saktë e privatizimit të kësaj NSH-je, por edhe obligimet e NSH-së lidhur me energjinë e shpenzuar elektrike. Po ashtu kishte dhënë sugjerime që në rigjykim të vërtetohet saktë se cila pjesë e kërkesës për borxh është parashkruar dhe për cilën periudhë kohore, dhe cila pjesë e borxhit të pretenduar ende nuk është parashkruar dhe për cilën periudhë kohore, nga se shitjet e asetëve të NSH-së kanë ndodhë në dy faza të ndryshme.

Me 22 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-22-0124 e aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit, ndërsa e anulon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN113-0370, në lidhje me borxhin e kërkuar në emër të shifrës DEF-9005536 si dhe detyron AKP-në të paguaj shumën e kompensimit prej 1.277,53 euro në emër të energjisë së shpenzuar elektrike nga NSH "IMB Mulliri" (në likuidim). Shkalla e I-rë me pikën e II-të të dispozitivit të Aktgjykimit e refuzon pjesën tjetër të kërkesës lidhur me borxhin e specifikuar që evidentohet me shifrën DFE-9012362 në shumë prej 6.664,96 euro, në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike nga NSH "IMB Mulliri" (në likuidim). Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në lidhje me borxhin që e pretendon paditësi ndaj të paditurës e që i referohet shifrës DEF-9005536, Gjykata ka gjetur se palët në procedurë kanë bërë prerje të borxhit për konsumatorin e privatizuar dhe se borxhi i cili i përket shifrës DFE-9005536 i përket periudhës kohore të vitit 2011, ndërsa kërkesa për këtë borxh është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 30 tetor 2013, që do të thotë kjo kërkesë e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Andaj në kuptim të nenit 17 të LMD-së e paditura ka për detyrim kompensimin e borxhit në shumë prej 1.277,53 euro për energjinë e shpenzuar elektrike. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se kërkesa e borxhit që kërkohet me shifrën DFE-9012362 në shumën prej 6.664,96 euro në bazë të nenit 374.1 të LMD-së të vitit 1978 është parashkruar, pasi që paditësi nuk e ka kërkuar borxhin brenda 3 viteve. ka arsyetuar se gjykata ka gjetur se borxhi në fjale i përket periudhës kohore prej vitit 2008 ndërsa

kërkesa për kompensimin e borxhit është bërë me datën 30 tetor 2013 që do të thotë se kjo kërkesë ishte parashtruar pas kalimit të afatit tre vjeçar që ishte koha e nevojshme për parashtrimin e kërkesave.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e AKP-së është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 30 tetor 2013, e ka paraqitur një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e faturave të energjisë së shpenzuar elektrike nga ana NSH "IMB Mulliri" (në likuidim). Kjo kërkesë është refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 374 të LMD-së të vitit 1978. Autoriteti i Likuidimit refuzimin e kërkesës e mbështet edhe në faktin se NSH-ja "IMB Mulliri" e cila është në likuidim nuk bart detyrime të cilat janë krijuar pas datës së privatizimit të kësaj NSH-je me datë 28 janar 2008, përkatësisht 10 shkurt 2011.

Paditësi në ankesën e tij e kundërshton qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është e parashkruar. Paditësi pohon se neni 374 i LMD nuk duhet të aplikohet si i izoluar por në lidhmëri me dispozitat e neneve të tjera të këtij ligji përkatësisht neni 360.3 të LMD-së të vitit 1978, sipas të cilit nuk mund të përfillet zyrtarisht parashkrimi nga organi që e vendos çështjen nëse atë nuk atë nuk e ka invokuar vetë debitori. Tutje paditësi pohon se borxhi për energjinë e shpenzuar elektrike është krijuar, dhe është i pa mohueshëm, andaj duhet të aprovohet ankesa e tij. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka

bashkangjitur transaksionet e konsumatorit me shifrën DFE-9012362, transaksionin e konsumatorit me shifrën DFE-9005536, prerjen e borxhit për konsumatorin e privatizuar me numër DFE-9012362, prerjen e borxhit e konsumatorit me nr. DFE-9005536, dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër PRN113-0370 të datës 09 mars 2015 si dhe një parashtresë të dt. 14 prill 2014 për përgjigje në krekës e AL lidhur me dy shifrat DFE-9005536 dhe DFE-9012362 .

Shkalla e I-rë e DHPGJS e aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit, ndërsa e anulon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit në lidhje me borxhin e kërkuar në emër të shifrës DEF-9005536 dhe i njeh paditësit shumën e kompensimit prej 1.277,53 euro në emër të energjisë së shpenzuar elektrike nga NSH "IMB Mulliri" (në likuidim), ndërsa me pikën e II-të të dispozitivit të Aktgjykimit e refuzon pjesën tjetër të kërkesës lidhur me borxhin e specifikuar që evidentohet me shifrën DFE-9012362 në shumë prej 6.664,96 euro, në emër të shfrytëzimit të energjisë elektrike nga NSH "IMB Mulliri" ( në likuidim).

Kolegji i Apelit i mbështet konstatimet dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së në lidhje me borxhin e të paditurës e që i referohet shifrës DEF-9005536, meqë ky borxh i përket periudhës kohore të vitit 2011, ndërsa kërkesa për këtë borxh është parashtruar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 30 tetor 2013. Me të drejtë Shkalla e I-rë ka konstatuar se kërkesa e paraqitur tek AL e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Andaj në kuptim të nenit 17 të LMD-së e paditura ka për detyrim kompensimin e borxhit në shumë prej 1.277,53 euro për energjinë e shpenzuar elektrike.

Kolegji i Apelit po ashtu e vlerëson si të drejte edhe konstatimin nga Shkalla e I-rë se kërkesa e borxhit që kërkohet me shifrën DFE-9012362 në shumën prej 6.664,96 euro në bazë të nenit 374.1 të LMD-së të vitit 1978 është parashkruar, pasi që paditësi nuk e ka kërkuar borxhin brenda 3 viteve për periudhën kohore prej vitit 2008 ndërsa kërkesa për kompensimin e borxhit është bërë me datën 30 tetor 2013 që do të thotë se kjo kërkesë ishte parashtruar pas kalimit të afatit tre vjeçar që ishte koha e nevojshme për parashtrimin e kërkesave.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, prandaj nuk mund të pajtohet me pretendimet e paditurës se kërkesa e paditësit është e parashkruar, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj. Shkalla e I-rë ka vlerësuar provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse dhe ka marr aktgjykim i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Kjo pasi që Shkalla e I-rë ka dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare duke dhënë shpjegime dhe arsyet adekuate dhe të bazuar në dispozita ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Prandaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e të paditurës si të pa bazuar dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesja tashmë ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 10 nëntor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 04 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_